



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

**Seksioni për Mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202002521/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** Rekomandim për marrjen e masave për vlerësimin me prioritet të nevojave të fëmijës me spektrin e autizmit të znj. T.E, hartimin e planit të mbrojtjes, për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqëror, deri në fuqizimin e familjes.

**BASHKISË SARANDË**

**SARANDË**

**SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR**

**TIRANË**

Institucioni i Avokatit të Popullit është vënë në dijeni, nga media *online*<sup>1</sup>, lidhur me problematikën e znj.T. E., nënë e dy fëmijëve, banuese në fshatin Derdenesh, Sarandë, dhe në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes "*ex-officio*" për rastin në fjalë.

Konkretisht, znj.E. është prind i dy fëmijëve, njëri prej të cilëve, vajza 7 vjeçe, vuan me çrregullime të spektrit të autizmit. Për këtë qëllim, ajo ka kërkuar ndihmë për të përshpejtuar akomodimin e vajzës së saj në një qendër të përkujdesit rezidencial. Situata e vajzës, nga informacioni i gjeneruar në media, paraqitet e rëndë, jo vetëm nga pikëpamja shëndetësore e të bijës, që shpesh bëhet agresive dhe dëmton veten, por edhe nga pikëpamja ekonomike, pasi nevojës së fëmijës për trajtime e terapi të veçanta, ajo nuk i përgjigjet dot, me shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) mijë lekë të kujdestarisë, që përfiton nga shteti. Ndaj në kushtet e papunësisë, të mungesës së strehimit, të zgjidhjes së martesës, të dhunës së pretenduar nga ish bashkëshorti dhe, kur nuk mund ta përballojë kujdesin për mirërritjen, zhvillimin dhe mbështetjen me trajtim terapeutik ndaj saj, ajo ka kërkuar ndihmën e shtetit<sup>2</sup>.

<sup>1</sup><https://top-channel.tv/2020/07/20/apeli-nenes-per-vajzen-me-autizem-me-ndihmoni-vajza-demton-veten/>

<sup>2</sup> Në muajin prill 2020, nëna e fëmijës ka dorëzuar dokumentacionin pranë Bashkisë Sarandë. Kronika dhe artikulli që e shoqëron, informojnë ndër të tjera, se "Nëna i ka dorëzuar dokumentet për rezidencë të vajzës në muajin prill. Në atë kohë punonjëset e

Duke konsideruar më të rëndësishmin e parësorin interesin më të lartë të fëmijës, për trajtimin e këtij rasti në nevojë emergjente për ndihmë e mbështetje nga strukturat shtetërore qendrore e vendore, paraqesim këtë rekomandim, për qasjen e aksesin në shërbimet e kujdesin e nevojshëm, që fëmija duhet të ketë.

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, parashikon të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për një standard adekuat jetese për ta dhe për familjet e tyre, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm, si edhe të drejtën për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe do të ndërmarrin hapat e duhura për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejtë pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre që jetojnë në kushtet e varfërisë, në asistencën e ofruar nga Shteti për të mbuluar shpenzimet lidhur me aftësinë e kufizuar, etj<sup>3</sup>. Në veçanti, Shtetet Palë do t'u garantojnë ato shërbime shëndetësore që u nevojiten personave me aftësi të kufizuar, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, duke përfshirë edhe identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen sipas rastit, si dhe shërbime të hartuara për të minimizuar dhe parandaluar përqekësimin e aftësive të kufizuara, duke përfshirë fëmijët<sup>4</sup>.

Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm për fëmijët është edhe një ndër objektivat kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së.

Komiteti i Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve, duke shprehur shqetësimin për situatën e fëmijëve në nivel global, veçanërisht ata në situata të cenueshme, për shkak të efekteve të pandemisë COVID-19, u ka bërë thirrje shteteve të përcaktojnë, cilat janë shërbimet bazë e thelbësore për mbrojtjen e fëmijëve, dhe të sigurojnë që ata të jenë funksionuese dhe të disponueshme, përfshirë vizitat në shtëpi kur është e nevojshme dhe, të ofrohen shërbime profesionale të shëndetit mendor për fëmijët që jetojnë të mbyllur (izoluara). Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me probleme të sjelljes, si dhe familjet e tyre, mund të përballen me vështirësi shtesë, për shkak të kufizimeve dhe masave administrative të veçanta. Strategjitë për të zbutur ndikimin ekonomik dhe shoqëror të pandemisë COVID-19 gjithashtu, duhet të përfshijnë masa specifike për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht ata që jetojnë në varfëri dhe nuk kanë qasje në strehimin e duhur<sup>5</sup>.

**Legjislacioni shqiptar**, ka të përcaktuar se interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje, aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës<sup>6</sup>.

---

shërbimit social të bashkisë bënë një vlerësim të gjendjes dhe ajo rrinte tek prindërit. Sot me të marrë njoftim që nëna bashkë me vajzën rri tek komshiu, ata vendosën të bëjnë një tjetër vlerësim të rastit dhe do të kërkojnë një zgjidhje emergjente të tij”.

<sup>3</sup> Neni 28 i Konventës së OKB mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

<sup>4</sup> Neni 25 i kësaj konvente.

<sup>5</sup> <https://tbinternet.ohchr.org/>, [CRC COVID-19 Statement](#), 8 prill 2020

<sup>6</sup> Pika 3 e nenit 6 të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfituar nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit. Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t'i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojës<sup>7</sup>.

Rasti konkret ka të bëjë me mbijetesën dhe problematikat e një nëne të re, 23 vjeç, bashkëshorti i së cilës ndodhet në Greqi, dhe pasi ka zgjidhur martesën, ajo vuan varfërinë dhe mungesën e një strehe edhe për dy fëmijët e saj të mitur, njëri prej të cilëve ka çrregullime të spektrit të autizmit, ndaj ky rast konsiderohet mjaft kompleks dhe emergjent për ndihmë. Detyrimin ligjor për fuqizimin e familjeve në kushtet e vështira social-ekonomike e ka pushteti vendor. Me qëllim mbrojtjen e fëmijës, është i domosdoshëm ofrimi i shërbimeve, sipas nevojave si dhe realizimin e ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e të miturit në mjedisin e tij familjar<sup>8</sup>.

Prindërimi pozitiv është thelbësor për rritjen e shëndetshme dhe plotësimin e nevojave të fëmijës. Mbrojtja kryesore e të drejtave të fëmijës nis në familje, nga prindërit dhe për të parandaluar dhe pakësuar rrisqet e mundshme, me të cilat mund të përballen fëmijët dhe për t'i pajisur prindërit me aftësitë përkatëse, jo të dhunshme dhe proaktive për të rritur fëmijët, prindërit kanë nevojë për mbështetje nga institucionet e pushtetit vendor, si dhe nga aktorë të tjerë, të cilët janë pjesë e sistemit. Ndërhyrjet dhe shërbimet duhen bazuar mbi njohuri të nevojave të fëmijës dhe familjes, dhe duhet të jenë të përshtatura për fëmijën.

Fëmijëria është një periudhë e rritjes së vazhdueshme, përmes moshës parashkollore deri në adoleshencë, fazat e zhvillimit të fëmijës janë kumulative dhe secila fazë ka ndikim në fazat pasuese, duke ndikuar në shëndetin, potencialin, rreziqet dhe mundësitë e fëmijës. Në këtë rast, parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të dy fëmijëve të kësaj familjeje, njeri prej të cilëve me autizëm, prevalon dhe është nevojë për një kujdes të shtuar dhe ndihmë të menjëhershme, për garantimin e kushteve të domosdoshme të mbijetesës, në kuadrin edhe të masave të diktuar nga kjo gjendje pandemie.

Në mbështetje të nenit 51, të ligjit 18/2017, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët; të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje, të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes.

---

<sup>7</sup> Pika 2 dhe 3 të nenit 32 të ligjit nr.18/2017.

<sup>8</sup> Neni 53, i ligjit 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Ndonëse në situatën e pandemisë së COVID-19 masat parandaluese synuan distancimin social, izolimin dhe të punuarit kryesisht nga shtëpia, dhe qeveria ka ndërmarrë një sërë masash, për të garantuar shëndetin publik, autoritetet shtetërore duhet të vlerësojnë dhe të kujdesen, që këto masa mos të cedojnë e çojnë në shkeljen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, si dhe të fëmijëve në veçanti. Është detyrë e të gjithëve së bashku, edhe në këtë situatë që shkaktoi pandemia nga COVID-19, që në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe, në zbatim të parimit të interesit më të lartë të tyre, të përpiqemi t'u garantojmë një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme e pa privime, e të mos lëmë askënd pas.

Avokati i Popullit ka sugjeruar që në kuadër të zbatimit të legjislacionit të ri të shërbimeve sociale, të udhëhequr nga plotësimi i nevojave apo minimizimi i ndikimit të pasojave negative të dukurive sociale tek fëmijët me aftësi të kufizuara, si mjaft të rëndësishëm, ngritjen, qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e punës për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale për identifikimin, vlerësimin, përfshirjen dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve. Sfida që lidhen me zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, janë ngritja e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve dhe hartimi i politikave gjithëpërfshirëse sociale në nivel vendor, bazuar në një bazë të dhënash të sakta mbi numrin e familjeve në nevojë si dhe kategoritë e fëmijëve me probleme sociale.

Përpjekje të shtuara, që të garantojmë të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë dhe fëmijët me nevoja të veçanta, larg përjashtimit dhe çdo lloj shkeljeje të të drejtave njerëzore janë dhe do të vazhdojnë të jenë prioritet i punës së Avokatit të Popullit e, në veçanti të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, të përfshira dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2019-2022 të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, si pjesë përbërëse e Planit Strategjik të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim me efikasitet e korrekt të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, dhe konkretisht të vendimit nr.578, datë 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

## **REKOMANDON:**

Marrjen e masave për menaxhimin efektiv të rastit, vlerësimin me prioritet e shpejtësi të nevojave të fëmijës së znj.T.E, hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar mbijetesën dhe mirëqënien e tij, duke konsideruar ofrimin e shërbimit të

kujdesit shoqëror në një qendër zhvillimi, në interesin më të lartë të fëmijës, deri në fuqizimin social, psikologjik e ekonomik të familjes.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

## **K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**